

20222904354

## МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА

Në bazë të nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit për tregti (\*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/04, 128/06, 63/07, 88/08, 159/08, 20/ 09, 99/09, 105/09, 115/10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 77/21, 215/21, 295/21 dhe 150/22) ministri i Ekonomisë, miratoi

### **R R E G U L L O R E** **PËR KUSHTET MINIMALE-TEKNIKE NË OBJKTET E SHITJES NË TË CILAT** **KRYHET TREGTI ME SHUMICË DHE PAKICË**

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet minimale-teknike që duhet të plotësohen për kryerjen e tregtisë me shumicë dhe pakicë në shitoret, shtëpi të mallrave, qendra tregtare (mole), vetëshërbimet, magazinat, depot, hapësirat afariste, tregjet e gjelbra, tregjet e posaçme me shumicë dhe pakicë, autoplacet, pompat e benzinës dhe objektet e shitjes në të cilat kryhet tregti në mënyra të veçanta (në tekstin e mëtejme: objekte të shitjes).

##### Neni 2

Kushtet minimale-teknike të përcaktuara me këtë rregullore kanë të bëjnë me:

1. Objektet e shitjes në të cilat kryhet tregtia me pakicë e mallrave me metoda të ndryshme të shitjes përmes shërbimit, vetëshërbimit (shitore vetëshërbyese), shtëpi të mallrave dhe pompa të benzinës (në tekstin e mëtejme: shitore);

2. Objektet e shitjes në të cilat kryhet tregtia me pakicë e një përzgjedhjeje të gjerë, respektivisht asortimentit të mallrave në qendrat tregtare të tipit të mbyllur ose të hapur dhe objekte të tjera në qendrat tregtare (në tekstin e mëtejme: qendrat tregtare (mole));

3. Objektet e shitjes në të cilat kryhet tregti me shumicë e mallrave përmes magazinës (në tekstin e mëtejme: magazina);

4. Objektet e shitjes në të cilat kryhet tregti me shumicë ose me shumicë dhe pakicë edhe në hapësira afariste (në tekstin e mëtejme: depo);

5. Objektet e shitjes në të cilat kryhet tregti me mallra bujqësore (në tekstin e mëtejme: tregjet e gjelbra) dhe

6. Objektet e shitjes në të cilat kryhet tregti në mënyra të veçanta:

- tregje me organizim të veçantë,
- kioska,
- makinat shitëse,
- shitës ambulante të lëvizshëm,
- autoplace,
- panairë dhe ekspozita ekonomike dhe
- panagjire.

##### Neni 3

Objektet e shitjes nga neni 2 i kësaj rregulloreje duhet të ndërtohen, rregullohen, pajisen dhe lidhen me objektet dhe pajisjet e infrastrukturës komunale, edhe atë: rrjetin e ujësjellësit, kanalizimin e ujërave të zeza dhe rrjetin elektrik.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, nëse objektet e shitjes ndodhen në zonë të paurbanizuar në të cilën nuk janë ndërtuar objekte dhe pajisje të infrastrukturës komunale, objektet duhet të ndërtohen, rregullohen dhe pajisen në përputhje me normat përkatëse teknike dhe rregulloret teknike.

#### Neni 4

Në hyrje të objektit të shitjes duhet të theksohet në mënyrë të dukshme emërtimi i firmës së personit juridik ose fizik që kryen tregti, selia e personit juridik ose fizik, numri i telefonit, si dhe shenja të tjera të veçanta në përputhje me veprimtarinë dhe llojin e objektit të shitjes.

Emërtimi i firmës nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë i ndriçuar gjatë orëve të natës.

Në hyrje të objektit të shitjes duhet të theksohet në mënyrë të dukshme edhe numri i telefonit i Inspektoratit Shtetëror të Tregut.

#### Neni 5

Sipërfaqja hyrëse përpara objektit të shitjes duhet të jetë e rregulluar dhe pajisur në atë mënyrë që të mundësojë pastrimin dhe mirëmbajtjen e lehtë të asaj sipërfaqe dhe të jetë ndërtuar në atë mënyrë që do të mundësojë hyrjen dhe qasjen e papenguar deri te objekti i shitjes në përputhje me rregulloret e veçanta.

Nëse përpara objektit të shitjes nuk ka trotuar të rregulluar, sipërfaqja e qasjes para objektit të shitjes dhe vitrinës duhet të jetë e asfaltuar, betonuar ose shtruar me gurë, respektivisht e ndërtuar në mënyrë tjetër ashtu që të sigurojë lëvizjen e papenguar të konsumatorëve dhe mirëmbajtjen e pastërtisë.

Qasja deri te objekti i shitjes që gjendet në oborr ose ndërtesë kolektive banimi duhet të jetë e rregulluar në atë mënyrë që të mos u pengojë përdoruesve të tjerë të ndërtesës gjatë përdorimit të atyre hapësirave.

#### Neni 6

Hapësira para objektit të shitjes mund të përdoret në kushtet e mëposhtme:

- të jetë më së shumti deri në një të tretën e sipërfaqes qasëse të objektit të shitjes, e llogaritur nga dera e hyrjes së përparme deri në skajin e trotuarit, shtegut ose hapësirës para objektit të shitjes;

- të mos jetë i rrethuar ose i mbyllur në çfarëdo mënyre;
- të mos pengojë lëvizjen e njerëzve dhe konsumatorëve;
- të jetë i pajisur me gondola të lëvizshme ose tezga të shitjes dhe pajisje përkatëse për shitje në të hapur dhe
- të mos kryhet pjekje ose gatim i produkte ushqimore që janë objekt i tregtisë.

## II. SHITORET

#### Neni 7

Shitorja, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, duhet të ketë së paku 6 m<sup>2</sup> sipërfaqe dhe së paku 2,5 m lartësi, me përjashtim të objekteve që janë nën mbrojtje në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Hapësira para hyrjes në shitoren duhet të jetë e ndriçuar.

#### Neni 8

Shitorja që është ndërtuar në tre ose më shumë kate duhet të ketë shkallë me gjerësi prej së paku 1.1 m.

Shitoret nga paragrafi 1 i këtij neni me sipërfaqe mbi 1200 m<sup>2</sup> duhet të kenë ashensor të instaluar për katër e më shumë persona ose shkallë lëvizëse (eskalator).

#### Neni 9

Dyshemeja në shitoren duhet të jetë ndërtuar prej materialit që mund të pastrohet lehtë (teraco, gurë, pllaka qeramike, përzierje të caktuara të integruara, gomë etj.), duhet të jetë i sheshtë dhe i lëmuar dhe të mos jetë i rrëshqitshëm.

Muret dhe tavani i shitores duhet të jenë të lyera dhe nuk duhet të jenë të dëmtuara.

Në shitoren ose në pjesën e shitores në të cilat kryhet shitje e mishit dhe peshkut të freskët, muret duhet të jenë të mbuluara me pllaka qeramike në lartësi deri të paktën 1.8 m nga dyshemeja.

#### Neni 10

Shitoret duhet të kenë nyje sanitare dhe ujë të ngrohtë dhe të ftohtë për nevoja personale.

Shitoret me sipërfaqe të shfrytëzueshme prej mbi 1200 m<sup>2</sup> duhet të kenë njësi sanitare me paradhomë dhe lavaman me ujë të nxehtë dhe të ftohtë veçmas për burrat dhe gratë.

#### Neni 11

Shitoret me sipërfaqe të shitjes prej mbi 1200 m<sup>2</sup> duhet të kenë agregat për prodhimin e energjisë elektrike për ndriçimin dhe drejtimin e pajisjeve për ftohje.

#### Neni 12

Shitorja duhet të ketë siguruar ajrosje të mirë natyrore dhe artificiale të hapësirave.

Shitorja në të cilën piqet dhe fërgohen pula, mish, peshk, salçiçe dhe produkte të tjera të mishit duhet të ketë aparat shtesë për ventilim artificial me kapacitet që siguron nxjerrjen e plotë të ajrit të ndotur nga shitoret.

#### Neni 13

Shitorja duhet të jetë e pajisur me rafte, tezgja, tavolina të shitjes, gondola dhe pajisje të tjera të ngjashme në varësi të organizimit të punës dhe llojit të mallrave që shiten në shitoren.

#### Neni 14

Shitorja duhet të përdorë arkë fiskale dhe mjete matëse (peshore etj.).

Arka fiskale dhe mjetet matëse duhet të vendosen në vende që do t'u mundësojnë konsumatorëve të shohin.

#### Neni 15

Në shitoren në të cilën kryhet shitja e veshjes duhet të ketë kabina për të provuar veshjet.

Kabinat duhet të jenë të ndriçuara, të kenë pasqyrë dhe varëse rrobash.

Në shitoren ku shiten mbajthje duhet të ketë të paktën dy ndenjëse dhe pasqyrë.

#### Neni 16

Shitorja ku shiten produkte ushqimore që prishen lehtë, duhet të ketë pajisje ftohëse.

#### Neni 17

Shitorja në të cilin shitja e mallrave me pakicë kryhet kryesisht me vetëshërbim të konsumatorëve (vetëshërbim), ndërsa sipërfaqja e saj është më e madhe se 400 m<sup>2</sup>, përveç kushteve të përcaktuara në nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje duhet të plotësojnë edhe këto kushte:

- të ketë numër adekuat të shportave dhe karrocave për bartjen e mallit;
- distanca ndërmjet rafteve me mallrat e ekspozuara duhet të jetë së paku 1 m, e nëse përdoren karroca me gjatësi të paktën 1,50 m;
- në hyrje të ketë hapësirë të veçantë për të lënë në ruajtje të mallrave që i sjellë blerësi dhe
- të ketë dhomë të veçantë për pranimin dhe magazinimin e mallrave.

#### Neni 18

Shtëpia e mallrave në të cilën kryhet shitja e përzgjedhjes së gjerë të mallrave sipas parimit të shërbimit ose vetëshërbimit, përveç kushteve të përcaktuara në nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje, duhet t'i plotësojë edhe kushtet e mëposhtme:

- madhësia e hapësirës së shitjes nuk duhet të jetë më e vogël se 500 m<sup>2</sup>, e lartësia 2,80 m;
- të ketë hapësirë të veçantë për pranimin dhe magazinimin e mallrave;
- të ketë ashensor mallrash për barjtjen e mallrave, nëse hapësira e shitjes është në kate;
- të ketë ashensor dhe shkallë lëvizëse (eskalator) nëse ka më shumë se dy kate;
- të ketë të paktën një nyje sanitare për femra dhe një për meshkuj, me paradhomë me lavaman me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë për konsumatorët, që janë të shënuara në mënyrë të dukshme dhe
- të ketë një sistem për informimin e konsumatorëve.

#### Neni 19

Shitoret në pompat e benzinës përveç kushteve të përcaktuara në nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje duhet të plotësojnë edhe këto kushte:

- të kenë tenda të paktën aq të gjera sa pjesa e përparme e shitores, me gjatë prej të paktën 6 m dhe lartësi prej të paktën 5 m;
- të kenë aparate për mbushjen e të gjitha llojeve të karburanteve të lëngëta me të cilat bëhet qarkullim, të regjistruara dhe të shënuara në mënyrë të rregullt me të dhëna për llojin e karburantit, çmimin e karburantit dhe litrazhin e lëshuar;
- për aparatet që kanë xham kontrolli, i njëjti duhet të jetë gjithmonë i mbushur dhe rrjedhja duhet të jetë pa fluska;
- të theksohet mbishkrimi "nuk përdoret" ose "me defekt" - nëse aparati nuk përdoret ose është me defekt;
- të kenë rezervuarë nëntokësor të ndërtuar posaçërisht për karburantet që përdoren si depo për nevojat e pompës;
- vrima mbi hapjen hyrëse të rezervuarit, respektivisht vrima në të cilën janë vendosur prizat e mbushjes së rezervuarit, duhet të jetë e papërshkueshme në mënyrë që të mos hyjnë uji dhe papastërtitë në karburantin;
- në kapakun e rezervuarit duhet të shënohet lloji i karburantit që gjendet në të njëjtin;
- të kenë shufër matëse të kalibruar siç duhet për matjen e karburantit;
- të kenë aparat për fryerjen e gomave;
- të kenë ujësjellës dhe pajisje sanitare me bojlerë për ujë të ngrohtë me së paku 30 litra, e nëse ka ujësjellës dhe nyje sanitare të qytetit, në mënyrë të ndarë për burra dhe për gra dhe
- në mënyrë të qartë dhe të lexueshme ta kenë të theksuar emërtimin e çdo derivati të naftës individualisht dhe çmimin e tij me përmasa të shkronjave dhe numrave prej të paktën 10 cm lartësi edhe atë në tabelë të ndriçuar me dimensionet prej të paktën 150 cm lartësi dhe 100 cm gjerësi, të ngritur të paktën 100 cm nga toka, të vendosur në hyrjen ose në vend tjetër të dukshëm në pompën e benzinës.

### III. QENDRA TREGTARE (MOLE)

#### Neni 20

Qendra tregtare (moli) përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

- të ketë të shënuar në mënyrë përkatëse të paktën një hyrje dhe dalje nëse është e tipit të mbyllur, me sipërfaqe deri në 10.000 m<sup>2</sup>, e nëse ka sipërfaqe mbi 10.000 m<sup>2</sup> të ketë të paktën dy hyrje dhe dalje;

- nëse është e tipit të hapur, duhet të mundësojë qasje të lehtë nga çdo anë e hyrjes dhe daljes;
- të ketë në dispozicion parking adekuat për automjetet sipas madhësisë së qendrës tregtare (molit);

- të ketë ashensor mallrash për bartjen e mallrave, nëse hapësira e shitjes është në kate;
- të ketë ashensor ose shkallë lëvizëse (eskalator) për konsumatorët nëse ka të paktën një kat;
- të ketë të paktën një nyje sanitare për femra dhe një nyje sanitare për meshkuj në çdo kat, me paradhomë me lavaman me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë për konsumatorët, që janë të shënuara në mënyrë të dukshme dhe

- të ketë sistem për informimin e konsumatorëve.

Qendra tregtare (mol) duhet të jetë e organizuar dhe mirëmbajtur si një tërësi, e përbërë nga objekte të shitjes dhe objekte të tjera që janë të lidhura me hapësirat e përbashkëta duke përfshirë shtigjet për këmbësorë, hapësirat e shërbimit, magazinat dhe hapësirat e tjera ndihmëse.

Objektet e shitjes nga paragrafi 2 i këtij neni janë: shitoret, kioskat dhe standat në të cilat shiten këto lloje të mallrave: produkte ushqimore, veshje, mbathje, kozmetikë, stoli, libra, muzikë, lodra, pajisje sportive, pajisje teknologjiko-informatike, dekorime dekorative dhe lloje të tjera të dekorimeve, aparate elektrike për amvisëri, mobilje, sigurim i shërbimeve etj.

Objektet tjera në qendrën tregtare (mol) nga paragrafi 2 i këtij neni mund të jenë së paku tri nga këto objekte: bankë dhe bankomat, respektivisht këmbimore, barnatore, kinema, restorant apo standë për ushqime të shpejta, kafene/kafiteri dhe lloje të lojërave argëtuese (kënd lojërash, vend loje me birila etj).

#### IV. MAGAZINAT

##### Neni 21

Magazina, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuar në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, duhet të plotësojë edhe këto kushte:

- të ketë qasje të papenguar për shkarkim dhe ngarkim të mallrave dhe hyrje të veçantë;
- të ketë pajisjen e nevojshme për vendosjen dhe manipulimin e mallrave;
- të ketë pajisje ftohëse nëse në magazinë ruhen produkte ushqimore që prishen lehtësisht;
- të ketë hapësira për punëtorët, garderobë, dollapë dhe pajisje sanitare;
- të ketë ventilim natyral ose artificial dhe të jetë i ndriçuar me ndriçim natyror dhe me pajisje për ndriçim artificial;
- magazina që ka më shumë se një kat duhet të ketë ashensor mallrash dhe shkallë me gjerësi përkatëse për bartjen e mallrave dhe
- të ketë nyje sanitare dhe ujë të ngrohtë dhe të ftohtë për nevoja personale.

#### V. DEPOT

##### Neni 22

Depoja, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, duhet të plotësojë edhe këto kushte:

- të gjendet në tokë të thatë, të kulluar ose të drenazhuar;
- të jetë e mbuluar ose e hapur në varësi të llojit të mallrave që shiten;
- të jetë e rrethuar;
- qasja deri te depoja duhet të jetë e shtruar me pllaka ose me material të fortë të ngjeshur për qasje të papenguar të automjeteve për ngarkesa dhe udhëtarë dhe hyrja në magazinë duhet të jetë e lirë dhe e ndriçuar;
- të jetë e ndriçuar me ndriçim natyror dhe me pajisje për ndriçim artificial;

- të ketë agregat për prodhimin e energjisë elektrike nëse ka frigorifer dhe dhoma për ngrohjen e mallrave të caktuara;
- varësisht nga lloji i mallrave, duhet të ketë pajisje, vegla dhe mjete të nevojshme për vendosjen, matjen dhe manipulimin e mallrave;
- të ketë hapësirë të veçantë për kryerjen e punëve administrative në lidhje me shitjen e mallrave në depot dhe
- të ketë nyje sanitare dhe ujë të ngrohtë dhe të ftohtë për nevoja personale.

#### Neni 23

Importuesi i derivateve të naftës, biokarburanteve dhe karburanteve për transport, për të kryer tregti me shumicë, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, duhet të ketë në dispozicion edhe depo të veçantë.

Depoja nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'i plotësojë këto kushte:

1) vëllimi minimal i rezervuarit të jetë 25 m<sup>3</sup> për biokarburant, 50 m<sup>3</sup> për gazin e lëngshëm të naftës (GLN), respektivisht 100 m<sup>3</sup> për derivat për derivatet e tjera të naftës dhe karburantet për transport dhe

2) rezervuarët duhet të jenë në një vend të rrethuar me gardh dhe hyrja dhe dalja të mos jenë të lidhura me pompën e benzinës.

Depot nga paragrafi 2 i këtij neni duhet t'i plotësojnë kërkesat e rregulloreve teknike për magazinimin dhe mbushjen e karburanteve të përcaktuara me ligj ose me rregullore tjetër.

### VI TREGJET E GJELBRA

#### Neni 24

Tregjet e gjelbra në të cilat shiten mallrat bujqësore me shumicë, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, duhet të plotësojnë edhe këto kushte:

- të kenë sipërfaqe prej të paktën 10.000 m<sup>2</sup>;
- të kenë hyrje dhe dalje të veçantë dhe parking dhe shtigje të rregulluara për mjete motorike transportuese me hapësira të shënuara për shitje;
- hapësira përpara hyrjes dhe daljes së tregut me shumicë të ndriçohet dhe përshtatet për lëvizjen e lirë të papenguar të mjeteve motorike dhe të konsumatorëve;
- të jetë i rrethuar;
- të jetë i ndriçuar në mënyrë adekuate;
- të ketë pajisje ftohëse për ruajtjen e mallrave që prishen lehtësisht;
- të ketë pajisje matëse, peshore automjetesh, peshore dhe mjete përkatëse për manipulimin e mallrave;
- të kenë të paktën një nyje sanitare për burra dhe gra në çdo 2000 m<sup>2</sup> sipërfaqe të shfrytëzueshme për nevojat e shitësve dhe konsumatorëve;
- të kenë hapësira të veçanta për të punësuarit për ushtrimin e punëve administrative dhe profesionale ndërmjet konsumatorëve dhe shitësve dhe të përdoret arkë fiskale;
- të kenë nyje sanitare për të punësuarit, për burrat dhe gratë me paradhomë me lavaman me ujë të nxehtë dhe të ftohtë;
- të kenë nga një çezmë në të hapur në çdo 1.000 m<sup>2</sup> hapësirë të shfrytëzuar;
- të kenë një të tretën e sipërfaqes së shfrytëzuar të mbuluar me strehë dhe
- të kenë hapësirë të posaçme të rrethuar për grumbullimin e mbeturinave të vendosur në dalje të tregut.

### Neni 25

Tregjet e gjelbërta ku mallrat bujqësore shiten me pakicë përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e mëposhtme:

- të kenë sipërfaqe prej të paktën 1.000 m<sup>2</sup> nëse në tregun e gjelbër kryhet shitja vetëm e mallrave bujqësore, respektivisht të paktën 1.500 m<sup>2</sup> nëse tregu i gjelbër ka edhe pjesë të organizuar në mënyrë të veçantë në të cilin kryhet shitje edhe e mallrave të tjera;

- të jenë të rrethuar;

- të kenë një hyrje dhe dalje të shënuar qartë, të ndriçuar në orët e natës;

- të kenë tezgja të standardizuara, të numëruara dhe me firmën e theksuar të tregtarit;

- çdo tezgë në të cilin shitësi nuk është prodhues bujqësor të përdorë arkë fiskale;

- distanca midis radhëve të tezgave duhet të jetë së paku 2 m për lëvizjen të papenguar të konsumatorëve;

- të ketë të paktën një nyje sanitare për burrat dhe gratë çdo 500 m<sup>2</sup> sipërfaqe të shfrytëzuar me një larës paradhomë me lavaman me ujë të nxehtë dhe të ftohtë për nevojat e shitësve dhe konsumatorëve;

- të ketë hapësirë për ruajtjen e peshoreve dhe pajisjes tjetër që u jepet shitësve;

- lartësia e hapësirës së mbyllur të shitjes duhet të jetë së paku 4 m dhe me ventilim të siguruar artificial;

- të ketë nga një çezmë në të hapur çdo 500 m<sup>2</sup> hapësirë të shitjes;

- të kenë të paktën një të tretën e sipërfaqes së shfrytëzuar të mbuluar me strehë;

- të ketë hapësirë dhe pajisje të veçanta për grumbullimin e mbeturinave dhe

- të kenë hapësira të veçanta administrative për të punësuarit me nyje sanitare për burrat dhe gratë me një paradhomë me lavaman me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë.

Hapësira e shitjes në të cilën kryhet shitje e qumështit, produkteve të qumështit dhe peshk duhet të mbyllet me tezgja për shitjen e këtyre mallrave.

Për shkak të prishjes së lehtë të mallrave nga paragrafi 2 i këtij neni, përveç ventilimit natyror, duhet të sigurohet ventilimi artificial (ventilatori dhe ngjashëm) dhe të paktën një kyçje për ujë për të mirëmbajtur higjienën e shitësve.

### Neni 26

Në pjesët e organizuara në mënyrë të veçantë të tregjeve të gjelbra ku kryhet shitja e mallrave të tjera, përveç kushteve të përcaktuara në nenin 25 të kësaj Rregulloreje, duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- të kenë të paktën 500 m<sup>2</sup> sipërfaqe;

- të kenë vende të shitjes - bokse të shënuara në mënyrë të veçantë, me sipërfaqe prej 4 m<sup>2</sup> për çdo tregtar veçmas me firmë të theksuar të tregtarit në mënyrë të qartë dhe të lexueshme dhe të përdoret arkë fiskale;

- vendet e shitjes - bokset, të renditen dhe grupohen sipas llojit të mallrave dhe

- distanca në mes të reshtave të vendeve të shitjes - bokseve duhet të jetë të paktën 2 metra për lëvizjen e papenguar të konsumatorëve dhe çdo vend i shitjes - boks, duhet të jetë i pajisur me rafte.

## VII OBJEKTE TË SHITJES NË TË CILAT KRYHET TREGTI NË MËNYRA TË VEÇANTA

### Tregje të organizuara në mënyrë të veçantë

### Neni 27

Tregjet e organizuara në mënyrë të veçantë për shitjen e automjeteve motorike dhe pjesëve të vjetra të automobilave (autoplace), përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje, duhet t'i përmbushin edhe këto kushte:

- të kenë sipërfaqe prej të paktën 5.000 m<sup>2</sup>;
- hapësira të jetë e rrethuar;
- hapësira para hyrjes dhe daljes së tregut për automjetet e vjetra motorike duhet të ketë ndriçim përkatës dhe të jetë i përshtatur për lëvizjen e papenguar dhe të lirë të shitësve dhe konsumatorëve;
- në tregun e automjeteve të vjetra motorike, hapësira për shitje duhet të shënohet në mënyrë të veçantë për automjetet e rënda motorike dhe të ketë hapësirë të veçantë për shitjen e pjesëve të vjetra të automobilave, të rregulluara me numër përkatës të tezgave të shitjes;
- çdo shitës duhet të përdorë arkë fiskale;
- në çdo tezgë të ketë firmë të theksuar në mënyrë të qartë dhe të lexueshme të tregtarit;
- tregu duhet të ketë hapësirë të veçantë për të punësuarit për të kryer punë administrative dhe profesionale, për të kryer shërbime për klientët;
- të ketë nga një çezmë në çdo 2.000 m<sup>2</sup> hapësirë të shfrytëzuar dhe
- të kenë të paktën nga një nyje sanitare për burrat dhe gratë çdo 2.000 m<sup>2</sup> hapësirë e shfrytëzuar për nevojat e shitësve dhe konsumatorëve.

#### Neni 28

Treg të organizuar në mënyrë të veçantë në të cilin kryhet tregit me shumicë dhe pakicë për shitjen e bagëtisë, shpendëve (pajisje dhe ushqim për bagëti), vegla bujqësore, dru për djegie, strukturë e sharruar dhe e latuar, si dhe produktet e përdorura, duhet të jetë jashtë vendbanimit, të jetë i rrethuar, të ketë sipërfaqe prej të paktën 1000 m<sup>2</sup>, të kenë hyrje dhe dalje të veçantë dhe në çdo 500 m<sup>2</sup> të ketë të vendosur çezme.

Hapësira para hyrjes dhe daljesa në treg nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të ketë ndriçim adekuat dhe të jetë i përshtatur për lëvizjen e papenguar dhe të lirë të bagëtive, shpendëve, mjeteve të transportit, shitësve dhe konsumatorëve.

Hapësira e tregut nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë i ndarë në mënyrë të veçantë për shpendët, bagëtitë e vogla, ndaras për bagëtitë e mëdha, ndërsa për bagëtitë e mëdha të ketë vend për të lidhur bagëtinë.

Tregu sipas paragrafit 1 të këtij neni, për bagëtitë dhe shpendët duhet të kenë pajisje për matjen e bagëtive/shpendëve, ujë të pijshëm për bagëtit/shpendët dhe hapësirë të veçantë për grumbullimin e mbeturinave.

Në qoftë në tregun nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet shitje edhe e veglave bujqësore, dru për djegie, strukturë e sharruar dhe e latuar, si dhe produktet e përdorura, ato duhet të veçohen nga bagëtia.

#### Neni 29

Tregu i mbyllur i organizuar në mënyrë të veçantë në të cilin kryhet shitja e mallrave nga disa tregtarë, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje, duhet t'i plotësojë edhe kushtet e mëposhtme:

- të ketë vende të shënuar në mënyrë të veçantë të shitjes (stenda) të shënuara për çdo tregtar veçmas me firmën e theksuar të tregtarit;
- çdo vend i veçantë i shitjes të përdorë arkë fiskale;
- distanca midis rreshtave të stendave duhet të jetë së paku 2 m për lëvizjen e papenguar të konsumatorëve;
- çdo vend i shitjes të jetë i pajisur me rafte;
- të ketë të paktën një kabinë provash me pasqyrë dhe varëse në çdo tri stenda për shitjen e veshjeve;
- të kenë të paktën dy vende për t'u ulur dhe një pasqyrë në çdo tri stenda për shitjen e mbathjeve dhe

- të ketë hapësira të posaçme administrative për të punësuar me nyje sanitare për burrat dhe gratë me një paradhomë me lavaman me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, të cilat janë të shënuara në mënyrë të dukshme.

### Kiosk

#### Neni 30

Kioska është hapësirë ku shitja e mallit me pakicë bëhen nëpërmjet sportelit, pa hyrjen e blerësit në hapësirën e shitjes.

Lartësia e kioskës nuk mund të jetë më e vogël se 2.20 m dhe hapësira e lirë në kioskën e lëvizjes së shitësit nuk duhet të jetë më e vogël se 2 m<sup>2</sup> me kusht që kioska të përmbushë kushtet në aspektin e kushteve mikroklimatike.

Kioska duhet të jetë e pajisur me raftë, tavolina të shitjes, gondola, vegla, pajisje matëse dhe pajisje ftohëse.

Pajisja sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet të përshtaten në varësi të llojit të mallrave dhe mënyrën se si ato shiten dhe të përpunuara nga materiale që pastrohen dhe mirëmbahen lehtë.

Gondolat mund të vendosen më së shumti nga të dyja anët.

Kioska duhet të ketë strehë jo më të madhe se 1.2 m.

Në qoftë se në kioskën kryhet shitje e bukës, brumërave, produkteve të mishit, qumështit dhe mallra me drithë që nuk janë në paketim origjinal, kioska duhet të pajiset me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë.

Kioska duhet të ketë të siguruar hapësirë ndihmëse për nevojat sanitare dhe higjienike të të punësuarve, në distancë më së shumti deri në 100 metra.

### Makina të shitjes

#### Neni 31

Shitja nëpërmjet makinerive të shitjes duhet të bëhen në përputhje me kushtet teknike dhe pajisjet e makinës së shitjes, në varësi të llojit të produktit.

Në makinën e shitjes duhet të theksohet firma e pronarit të makinës së shitjes.

### Shitësi ambulan i lëvizshëm

#### Neni 32

Shitësi ambulant i lëvizshëm e kryen shitjen me:

- automjet motorik ose rimorkio që duhet të ketë të paktën 3 m<sup>2</sup> hapësirë të shitjes dhe 1.5 m lartësi dhe

- karrocë të lëvizshme, e cila gjatë shitjes së mallra ushqimore duhet të mbyllet me material të tejdukshëm.

Në çdo automjet motorik ose rimorkio dhe karrocë të lëvizshme duhet të theksohet qartë firma e tregtarit.

Çdo shitës ambulant i lëvizshëm duhet të ketë një distinktiv identifikimi në vend të dukshëm të veshjes.

Shitja e mallrave në gjendje të ngrirë ose të ftohtë mund të kryhet nëse shitësi ambulant i lëvizshëm ka pajisje për ftohje.

Shitësit ambulant të lëvizshëm në vendin ku kryejnë shitjen të mos pjekin, fërgojnë ose gatujnë produkte ushqimore që janë lëndë e tregtisë.

## Panaire, ekspozita afariste dhe panagjire

### Neni 33

Panairët mund të organizohen në hapësirë përkatëse të mbyllur.

Ekspozitat afariste dhe panagjirët mund të organizohen në hapësirë përkatëse të brendshme dhe të hapur.

Panairët, ekspozitat afariste dhe panagjirët e organizuara në hapësirë përkatëse të mbyllur, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje, duhet të plotësojnë edhe kushtet e mëposhtme:

- të kenë hapësirë prej së paku 1.000 m<sup>2</sup>;
- të kenë pajisje për ekspozimin e mallrave;
- të kenë pajisje për manipulimin e mallrave në varësi të llojit të mallrave;
- të kenë hapësira për kryerjen e punëve administrative dhe takimeve dhe
- të kenë hapësira ndihmëse për nevojat higjieniko-sanitare.

Hapësira para panairit dhe hyrja e panairit duhet të ndriçohet dhe të përshtatet për lëvizjen e papenguar dhe të lirë të vizitorëve.

Nëse ekspozitat afariste dhe panagjirët janë organizuar në hapësirë të hapur, ato duhet të kenë hapësirë prej së paku 1.000 m<sup>2</sup>.

## VIII KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 34

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja për kushtet minimale-teknike për hapësirat afariste dhe hapësirat në të cilat kryhet tregti ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 21/04, 54/04, 79/04, 70/07, 93/08, 124/11 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 69/21).

### Neni 35

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 11 – 3440/4  
29.12.2022  
Shkup

Ministri i Ekonomisë,  
**Kreshnik Bekteshi**, d.v.